



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 195

Tiranë – E premte, 17 dhjetor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 113/2021, datë 25.11.2021	Për një ndryshim në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar..... 18525
Ligj nr. 114/2021, datë 25.11.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 18526
Dekret i Presidentit nr. 13383, datë 15.12.2021	Për shpallje ligji..... 18533
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 767, datë 15.12.2021	Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2021..... 18533
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 769, datë 15.12.2021	Për kriteret e mbështetjes së nismave, të projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional e fetar dhe kriteret e përzgjedhjes për financimin dhe administrimin e fondit për pakicat kombëtare..... 18535
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 770, datë 15.12.2021	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare “Demokracia”, Valias i Ri, Bashkia Kamzë, dhe caktimin e Bashkisë Kamzë si njësi zbatuese..... 18538
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 771, datë 15.12.2021	Për disa ndryshime në vendimin nr. 587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e reja për zhvillim dhe rindërtim në të njëjtin truall”, të ndryshuar..... 18539
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 772, datë 15.12.2021	Për disa ndryshime në vendimin nr. 202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre banesave”, të ndryshuar..... 18539

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 773, datë 15.12.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 645, datë 3.8.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesave publike, në zonat e reja për zhvillim, në njësitë administrative 4 e 8, zona ‘5 Maji’, dhe Njësine Administrative 6, zona ‘Kombinat’, Bashkia Tiranë”, të ndryshuar	18540
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 774, datë 15.12.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore”, të ndryshuar.....	18540
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 775, datë 15.12.2021	Për miratimin e llojeve të sinjaleve të alarmit, numrit dhe mënyrës së përdorimit të tyre në rastet e fatkeqësive.....	18541
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 776, datë 15.12.2021	Për miratimin e rregullave dhe procedurave të krijimit të sistemit të gjurmimit të artikulave piroteknikë.....	18542
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 779, datë 15.12.2021	Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit 2021.....	18543
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 15.12.2021	Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2022, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU).....	18544
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 783, datë 15.12.2021	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i segmentit rrugor, nyja TEG”.....	18545
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 15.12.2021	Për disa ndryshime në vendimin nr. 843, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Rruga lidhëse e Apolonisë’”.....	18548
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 785, datë 15.12.2021	Për shfuqizimin e vendimit nr. 736, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit ‘Sistemimi i bllokut të banimit në lagjen ‘Kongresi i Lushnjës’, pallati 31, tek ish-Kinemaja’, Lushnjë’”.....	18550
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 789, datë 15.12.2021	Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe trajtimin e sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, dhe trajnerëve të tyre	18550
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 790, datë 15.12.2021	Për lirimin nga detyra të drejtorit të Cirkut Kombëtar.....	18553
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 378, datë 10.12.2021	Për delegim kompetence.....	18553
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 520, datë 3.12.2021	Për ndalimin e hyrjes në Republikën e Shqipërisë të shtetasve të huaj me histori udhëtimi në vendet e Afrikës së Jugut.....	18553



LIGJ
Nr. 113/2021

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.
8438, DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN
MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, pasqyra nr. 1,

Pasqyra nr. 1

Tabela për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi

E ardhura nga paga në lekë/muaj		E ardhura e tatueshme në lekë/muaj		Norma tatimore në përqindje/mujore
Nga	Deri në	Nga	Deri në	
0	40 000	0	40 000	0%
40 001	50 000	0	30 000	0%
		30 001	50 000	50% * 13% të shumës mbi 30 000 lekë
50 001	Më tepër	0	30 000	0%
		30 001	200 000	13% e shumës mbi 30 000 lekë
		200 001	Më tepër	22 100 lekë + 23% të shumës mbi 200 000 lekë

“Tabela për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi” zëvendësohet me pasqyrën nr. 1 “Tabela për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi” që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet duke filluar nga data 1 korrik 2022.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 25.11.2021



LIGJ
Nr. 114/2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 61/2012,
“PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR¹

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

1.

2. Në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

3.

Neni 1

Në nenin 14, pika 1, shkronja “d”, pas fjalëve “të shitur me faturë TVSH-je” shtohen fjalët “deri më 31 dhjetor 2023”.

Neni 2

Në nenin 18, pas pikës 2, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Akciza e llogaritur sipas pikës 2 të këtij neni, indekssohet çdo dy vjet në masën e normës zyrtare të inflacionit për dy vitet paraardhëse shpallur nga INSTAT-i, me përjashtim të duhanit dhe nënprodukteve të tij, për të cilat akciza aplikohet sipas kalendarit specifik të përcaktuar në shtojcën nr. 1 që i bashkëlidhet ligjit.

¹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me:

Direktivën e Këshillit 2011/64/BE, datë 21 qershor 2011, “Mbi strukturën dhe normat e akcizës që aplikohen për duhanin e prodhuar”. Numri CELEX 32011L0064, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 176, datë 5.7.2011, faqe 24–36.

Direktivën e Këshillit 2003/96/KE, datë 27 tetor 2003, “Ristrukturimi i kuadrit komunitar për taksimin e produkteve të energjisë dhe energjisë elektrike”, e ndryshuar. Numri CELEX 32003L0096, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 283, datë 31.10.2003, faqe 51–70.

Përjashtimisht përcaktimit të paragrafit të parë të kësaj pike, për vitin 2022 akciza indekssohet në masën e normës zyrtare të inflacionit të vitit 2020 dhe 9-mujorit të vitit 2021.”.

Neni 3

Në nenin 41, pika 8, shkronja “ç”, fjalja e dytë dhe në vijim ndryshohen si më poshtë:

“Depozituesi i miratuar njofton me shkrim ose në formë elektronike zyrën doganore mbikëqyrëse 72 orë përpara fillimit të vendosjes së pullave. Për të mundësuar mbikëqyrjen e gjithë procesit të vendosjes së pullave, autoritetet doganore mbikëqyrëse i kërkojnë depozituesit të miratuar marrjen e të gjitha masave për vendosjen dhe funksionimin e rregullt të sistemit të kamerave në ambientet ku kryhet vendosja e pullave dhe paraqitjen e rakordimeve për çdo proces pullosjeje. Autoritetet doganore kompetente, kur e konsiderojnë të nevojshme, sigurojnë prezencën e tyre përgjatë procesit të vendosjes së pullave.”.

Neni 4

Në nenin 51 pika 3 shfuqizohet.

Neni 5

Në nenin 90 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 deri në pikën 5 të tij, kudo ku përmendet shprehja “2 për qind” zëvendësohet me shprehjen “2 për qind të sasisë kontabël të llogaritur për periudhën objekt kontrolli”.

2. Në pikën 8 hiqen fjalët “të destinuara për eksport”.

3. Në pikën 10, pas fjalëve “ose mangësitë në pulla fiskale” shtohen fjalët “përveç humbjeve të pranuar”.

Neni 6

Në nenin 92, fjalët “500 000 lekë” zëvendësohen me fjalët “50 000 lekë”.

Neni 7

Neni 94/1 ndryshohet si më poshtë:



“Neni 94/1

**Tepricat ose mangësitë e pullave fiskale tek
operatorët ekonomikë, jodepozitues
të miratuar**

Tepricat ose mangësitë në pullat fiskale të konstatuara gjatë kontrollit të operatorëve ekonomikë, të cilët nuk janë depozitues të miratuar, që rezultojnë mbi 2% të sasisë kontabël të llogaritur për periudhën objekt kontrolli, përveç humbjeve të pranuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në përputhje me përcaktimet e shkronjës “b”, të nenit 259, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Pagesa e gjobës në asnjë rast nuk shmang shkelësin nga pagimi i detyrimit të munguar të akcizës për sasinë e pullave me diferencë.”.

Neni 8

Në nenin 95 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në paragrafin e parë hiqet fjala “eksportimi”.
2. Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) në çdo rast të konstatuar, me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar për sasinë e produktit të gjendur të pa markuar/shënjuar apo ngjyrosur, bazuar në rezultatet e analizimit/testimit;”.

Neni 9

Në nenin 97, në pikën 4, në fjalinë e fundit fjalët “5 (pesë)” bëhen “10 (dhjetë)”.

Neni 10

Në nenin 99, pika 2, fjalët “brenda 10 ditëve” zëvendësohen me fjalët “brenda 60 ditëve”.

Neni 11

Në nenin 105 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 4 fjalët “brenda 30 ditëve” zëvendësohen me fjalët “brenda 60 ditëve”.

2. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Kundër vendimit të drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, ankimesi mund të ankohet pranë autoriteteve gjyqësore brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e njoftimit të mospranimi të ankesës, ose brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga mbarimi i afatit të shqyrtimit të ankimit, të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni.”.

Neni 12

Shtojca nr. 1, “Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë”, bashkëlidhur ligjit, zëvendësohet me shtojcën nr. 1 “Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë”, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 25.11.2021.

**Shpallur me dekretin nr. 13383, datë 15.12.2021,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta.**

Shtojca 1

MALLRAT E TATUESHME ME AKCIZË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Kategoria	Kodi NK	Përshkrimi	Shkalla taksimit
I. KAFE			
C100 Kafe e papjekur	09 01 11 00 09 01 12 00	Kafe jo e pjekur e dekafeinizuar ose jo	0
C200 Kafe e pjekur	09 01 21 00 09 01 22 00	Kafe e pjekur e dekafeinizuar ose jo	60 lekë/kg
C300 Lëkura, lëvoret zëvendësuesit e kafesë	09 01 90	Lëkura dhe lëvoret e kafesë. Zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe.	50 lekë/kg
C900 Ekstrakte, esenca, koncentre kafeje dhe përgatitje prej tyre	21 01 11 00 21 01 12 92 21 01 12 98	Ekstrakte, esenca, koncentre kafeje dhe përgatitje prej tyre (neskafë etj.).	250 lekë/kg kafe



II. BIRRË, VERË, ALKOOL DHE PIJE ALKOOLIKE			
B000 Birrë e bërë nga malto	2203	Nga prodhues vendas e të huaj, ligjërishdhe ekonomikisht të pavarur, me sasi më të vogël se 200 000 HL në vit;	360kë/HL/shkallë alkoolometrike
		Nga prodhues vendas e të huaj, ligjërishdhe ekonomikisht të pavarur, me sasi më të madhe se 200 000 HL në vit.	710 lekë/HL/shkallë alkoolometrike
W200 Vera e qetë dhe pijet e qeta të fermentuara	22 04 21 22 04 29 22 04 30 22 04 30 10 22 04 30 96 22 04 30 98 22 05 10 10 22 05 90 10 22 06 00 10 22 06 00 59 22 06 00 89	Verë e qetë dhe musht rrushi; Vermuth e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese; pije të tjera të fermentuara (p.sh.: musht molle, musht dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe përzierje të pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të pagazuara: - nga prodhues vendas e të huaj me sasi < = 10 000 hektolitër/vit; - nga prodhues vendas e të huaj me sasi > 10 000 hektolitër/vit.	-3 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike deri në 12,5 gradë; dhe -4 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike mbi 12,5 gradë. -10 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike deri në 12,5 gradë dhe; -12 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike mbi 12,5 gradë.
W300 Vera spumante, shampanja dhe pije të fermentuara dhe të gazuara	22 04 10 22 04 21 06 22 04 21 07 22 04 21 08 22 04 21 09 22 05 10 10 22 05 90 10 22 06 00 39 22 06 00 31 22 06 00 51 22 06 00 81	Verërat spumante, Shampanja; verë ndryshe nga ato të nënkreut 220410, në shishe me tapa “kërpudhë”, që lidhet me mbërthyes apo tela; verë e ndërtuar ndryshe me një presion të pranueshëm në sajë të dyoksidit të karbonit; Vermuth e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese të një force alkoolike ndaj volumit prej 18% apo më pak.	5 200 lekë/HL
		Pije të tjera të fermentuara (p.sh.: musht molle, musht dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe përzierjet e pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të gazuara. Cider dhe cider dardhe me përmbajtje alkooli 8,5%.	3120 lekë/HL
I000 Pijet alkoolike të ndërmjetme	22 04 21 85 22 04 21 86 22 04 21 87 22 04 21 88 22 04 21 89 22 04 21 90 22 04 21 91 22 04 21 93 22 04 21 94 22 04 21 95 22 04 21 96	Pijet alkoolike të ndërmjetme me një forcë alkooli mbi 15% volum, por që nuk e kalon 22% volum, sipas përcaktimeve të nenit 74 të ligjit.	5 200 lekë/HL



	22 04 21 97 22 04 21 98 22 04 29 85 22 04 29 86 22 04 29 87 22 04 29 88 22 04 29 89 22 04 29 90 22 04 29 91 22 04 29 93 22 04 29 94 22 04 29 95 22 04 29 96 22 04 29 97 22 04 29 98 22 05 10 10 22 05 10 90 22 05 90 10 22 05 90 90 22 06 00 10 22 06 00 39 22 06 00 59 22 06 00 89		
S200 Pije alkoolike (<i>Spirituos Beverages</i>)	22042192 22042193 22042194 22042195 22042196 22042197 22042198 22042992 22042993 22042994 22042995 22042996 22042997 22042998 22051090 22059090 22060010 22060039 22060059 22060089 22082012 22082014 22082026 22082027 22082029 22082040 22082062 22082064 22082086 22082087 22082089 22083011 22083019 22083030 22083041 22083049 22083061 22083069 22083071 22083079 22083082 22083088 22084011 22084031	Pije alkoolike; të përfituara nga distilimi i verës së rrushit apo të bërësve të rrushit, Whisky, Rum dhe të tjera pije të përfituara nga distilimi i produkteve të fermentuara nga kallami i sheqerit, Gin dhe Geneva, Vodka, likere dhe tonike, Uzo: - nga prodhues vendas e të huaj me sasi < = 20 000 hektolitër/vit; - nga prodhues vendas e të huaj me sasi > 20 000 hektolitër/vit.	65 000 lekë për HL alkool anhidër; 84 500 lekë për HL alkool anhidër.



	22084039 22084051 22084091 22084099 22085011 22085019 22085091 22085099 22086011 22086019 22086091 22086099 22087010 22087090 22089011 22089019 22089033		
S300 Alkooli etilik jo i denatruar	22071000 22089091 22089099	Alkool etilik jo i denatruar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80% volum apo më shumë.	45 000 lekë për HL alkool anhidër.
S400 Alkool etilik i denatruar	22072000	Alkool etilik i denatruar.	0 (zero)
S400 Rakia sipas përcaktimeve të nenit 66 të ligjit	22082029	Raki.	20 000 lekë për HL alkool anhidër.
S500 Produkte të tjera që përmbajnë alkool etilik	Kapitujt 17 deri 22 të NK	Të gjitha produktet që kanë një shkallë alkoolometrike efektive mbi 1,2% ndaj volumit dhe pavarësisht klasifikimit në sistemin NK, sipas nenit 64 të ligjit.	45 000 lekë për HL alkool anhidër.
III.DUHAN DHE NËNPRODUKTET E TIJ			
T300 Puro dhe cigarillos	24 02 10 00	Puro dhe cigarillos që përmbajnë duhan (lek/kg).	6750 lekë/kg, në 1 janar 2022; 7000 lekë/kg, në 1 janar 2023; 7250 lekë/kg, në 1 janar 2024; 7500 lekë/kg, në 1 janar 2025; 7750 lekë/kg, në 1 janar 2026.
T200 Cigare që përmbajnë duhan	24 02 20	Cigare që përmbajnë duhan (lek/fije cigare).	6750 lekë/1000 fije, në 1 janar 2022; 7000 lekë/1000 fije, në 1 janar 2023; 7250 lekë/1000 fije, në 1 janar 2024; 7500 lekë/1000 fije, në 1 janar 2025; 7750 leke/1000 fije, në 1 janar 2026.
T500 Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	24 02 90	Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani (lek/kg).	6750 lekë/kg, në 1 janar 2022; 7000 lekë/kg, në 1 janar 2023; 7250 lekë/kg, në 1 janar 2024; 7500 lekë/kg, në 1 janar 2025; 7750 lekë/kg, në 1 janar 2026.
T400 Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit	2403	Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit, duhan me dredhje (lek/kg).	6750 lekë/kg, në 1 janar 2022; 7000 lekë/kg, në 1 janar 2023; 7250 lekë/kg, në 1 janar 2024; 7500 lekë/kg, në 1 janar 2025; 7750 lekë/kg, në 1 janar 2026.
		Duhan i përpunuar me gjethe duhani të kultivuar në Shqipëri (lek/kg).	2750 lekë/kg, në 1 janar 2022; 3000 lekë/kg, në 1 janar 2023; 3250 lekë/kg, në 1 janar 2024; 3500 lekë/kg, në 1 janar 2025; 3750 lekë/kg, në 1 janar 2026.
T401 Nikotinë	2404 12	Produktet që përmbajnë nikotinë lëng (lek/ml).	12 lekë/ml në 1 janar 2022; 14 lekë/ml në 1 janar 2023; 16 lekë/ml në 1 janar 2024; 18 lekë/ml në 1 janar 2025;



			20 lekë/ml në 1 janar 2026.
	2404 91	Produkte duhani për përdorim oral (lek/kg).	6750 lekë/kg, në 1 janar 2022; 7250 lekë/kg, në 1 janar 2023; 7750 lekë/kg, në 1 janar 2024; 8250 lekë/kg, në 1 janar 2025; 8750 lekë/kg, në 1 janar 2026.
T402 Duhan me ngrohje	24 04 11	Duham me ngrohje, pa djegie (lek/kg).	6750 lekë/kg, në 1 janar 2022; 7250 lekë/kg, në 1 janar 2023; 7750 lekë/kg, në 1 janar 2024; 8250 lekë/kg, në 1 janar 2025; 8750 lekë/kg, në 1 janar 2026
T403 Shisha, nargjile	24 03 11	Shisha, nargjile (përzierje për tymosje) (lek/kg duhan në produkt).	6750 lekë/kg, në 1 janar 2022; 7250 lekë/kg, në 1 janar 2023; 7750 lekë/kg, në 1 janar 2024; 8250 lekë/kg, në 1 janar 2025; 8750 lekë/kg, në 1 janar 2026
		Shisha, nargjile (përzierje për tymosje) përpunuar me gjethe duhani të kultivuara në Shqipëri (lek/kg duhan në produkt).	2750 lekë/kg, në 1 janar 2022; 3000 lekë/kg, në 1 janar 2023; 3250 lekë/kg, në 1 janar 2024; 3500 lekë/kg, në 1 janar 2025; 3750 lekë/kg, në 1 janar 2026.
IV. PRODUKTET ENERGJETIKE			
E200 Vajrat vegjetale dhe shtazore të klasifikuara në krrerët 1507 deri 1518 të NK, nëse përdoren për ngrohje apo motorë	1507 deri 1518	Vajrat dhe dhjamërat prej kafshëve apo vegjetale dhe produktet prej tyre.	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51, të ligjit.
E201 Qymyri	2701	Qymyr, briketa, forma vezake dhe lëndë djegëse të ngjashme të forta të prodhuar prej qymyrit.	0 lek/kg
E202 Linjiti	2702	Linjit, nëse është apo jo i aglomeruar, duke përjashtuar qelibarin e zi.	0 lek/kg
E203 Koks dhe gjysmëkoks	2704	Koks dhe gjysmëkoks prej qymyrit, linjtit apo prej torfe, nëse është apo jo i aglomeruar, karbon i konvertuar.	0 lek/kg
E204 Gaz qymyri, gaz uji, gaz prodhimi	2705	Gaz qymyri, gaz uji, gaz prodhimi dhe gazra të tjera të ngjashme, përveç gazrave të naftës dhe hidrokarbureve të tjera gazoike.	0 Lek/kg
E205 Katran i distiluar nga qymyri	2706	Katran i distiluar nga qymyri, nga linjiti apo nga torfa, dhe katrane të tjera minerale, nëse janë apo jo të dehidratuara apo pjesërisht të distiluara, përfshirë katranet e rindërtuara.	0 lek/kg
E300 Vajra minerale	27071010 27071090 27072010 27072090 27073010 27073090 27075010 27075090	Produktet e vajrave minerale që i përkasin kodeve NK, të kreut 2707.	50 lekë/litri
E400	27 10 12 11	Naftë që kërkon një proces specifik përpunimi.	50 lekë/litri
E410	27 10 12 41 27 19 12 45 27 10 12 49	Vajra të lehta (benzinë dhe benzol), benzinë dhe benzol pa plumb, me përmbajtje plumbi jo më tepër se 0,013 gr/litër: me më pak se 95 oktan;	37 lekë/litri



		me 95–98 oktan; me 98 e më shumë oktan.	
E420	27 10 12 51 27 10 12 59	Benzinë me plumb, me përmbajtje plumbi më tepër se 0,013 gr/litër; me më pak se 98 oktan; me 98 e më shumë oktan.	50 lekë/litri
E430	27 10 19 11 deri 27101929 27101921 deri 27 10 19 25	Vajguret, karburantet, tip vajguri.	20 lekë/litri 20 lekë/litri
E440	27 10 19 31 deri 27101948	Vajra të rënda (gazoil).	37 lekë/litri
E450	27 10 19 51 deri 27101969	Vajra të rënda si lëndë djegëse (lëndë djegëse, solar, mazut).	37 lekë/kg
E460	2710 20	Biodiesel me vajra nafte.	37 lekë/kg
E470	27 10 19 71 deri 271019 99	Vajra lubrifikante dhe vajra të tjera.	40 lekë/kg
E471	27 109 100 deri 27109900	Mbetje vajrash.	5 lekë/kg
E472	27 12 10 90	Graso.	40 lekë/kg
E480	27 13 11 00 27 13 12 00	Koks nafte.	2 lekë/kg
E490	27 13 20 00	Bitum nafte.	5 lekë/kg
E490	27 13 90	Mbetje të vajrave të naftës dhe të mineraleve bituminoze (bitumen).	5 lekë/kg
E491	27 15	Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyror, në bitumen e naftës, në katranin mineral, ose në terنتينën e katranit mineral (mastixhet bituminoze), vernik bituminoz (p.sh. asfalto-beton).	5 lekë/kg bitum
E492	27 14 90 00	Zhavorr bituminoz.	0,3 lekë/kg
E500 Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike	27111211 27111219 27111291 27111293 27111294 27111297 27111310 27111330 27111391 27111397 27111400	Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim si lëndë djegëse për motor automjesh.	8 lekë/litri në 1 janar 2022 deri në 1 korrik 2022; 6 lekë/litri nga 1 korriku 2022.
		Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim të ndryshëm nga ai si lëndë djegëse për motor automjesh.	0 lekë/litri në 1 janar 2022 deri në 1 korrik 2022; 6 lekë/litri nga 1 korriku 2022.
E600 Hidrokarburet aciklike	2901	Hidrokarburet aciklike.	37 lekë/kg
E700 Hidrokarburet ciklike	2902	Hidrokarburet ciklike.	37 lekë/kg
E800 Metanol (alkooli metilik)	29051100	Metanol (alkooli metilik).	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51, të ligjit.
L000	34 03 19 10 34 03 99 00	Preparate për lubrifikimin e makinerive, pajisjeve dhe automjeteve.	40 lekë/kg
L000 Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi; alkibenzenet e përziera	3811 dhe 3817	Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi, stabilizator rrëshire, përmirësues viskoziteti, kundër korrozionit, dhe elemente shtesë të përgatitura për vajrat minerale (përfshirë benzinën) apo lëngje të tjera të përdorura për qëllime të tjera si vajrat minerale; alkibenzenet e përziera dhe alkinaftalenet e përziera.	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51, të ligjit.



E920 Biodiezel	3826 00	Acidet yndyrore/biodiezel me më pak se 70% vajra nafte të kapitullit 27.	37 lekë/litri
V. FISHEKZJARRËT			
F000 Fishekzjarrët	36 04 10 00	Fishekzjarrët.	200 lekë/kg
F000	36 04 90 00	Të tjera.	200 lekë/kg
VI.GOMAT			
P100 Goma të reja	40 11	Goma të reja pneumatike prej gome.	20 lekë/kg
P200 Goma të riveshura	40 12 (përveç 40 12 20 00)	Goma pneumatike të riveshura; goma mishi apo të zakonshme; veshja e jashtme (pjesa me lule) dhe fashetat e gomës.	40 lekë/kg
VII. PILAT DHE BATERITË PRIMARE; AKUMULATORËT ELEKTRIKË			
A200 Akumulatorët	85 07	Akumulatorët elektrikë, përfshirë ndarëset e tyre, nëse janë apo jo drejtkëndëshe (përfshirë katrorët).	20 lekë/kg

DEKRET**Nr. 13383, datë 15.12.2021****PËR SHPALLJE LIGJI**

NË mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 114/2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM**Nr. 767, datë 15.12.2021**

**PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË
PRANIMIT NË KATEGORINË E ULËT
DHE TË MESME DREJTUESE EDHE
PËR KANDIDATË TË TJERË JASHTË
SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2021**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për vitin 2021, procedura e plotësimit të pozicioneve të lira të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, për të cilat lëvizja paralele është mbyllur pa fitues, të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendet e lira.

2. Numri maksimal i pozicioneve, për të cilat do të përdoret procedura e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, është:

a) 12 pozicione për kategorinë e mesme drejtuese;

b) 33 pozicione për kategorinë e ulët drejtuese.

3. Pozicionet, në të cilat mund të konkurrojnë edhe kandidatë nga jashtë shërbimit civil për nivelin e mesëm drejtues, gjithsej 12, si dhe për nivelin e ulët drejtues, gjithsej 17, përcaktohen në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

**Lidhja 1****POZICIONET NË TË CILAT MUND
KONKURROJNË EDHE KANDIDATË
NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL****I. Niveli i mesëm drejtues dhe i barasvlershëm**

1. Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Kulturës, kategoria II-b;

2. Kryeadministrator i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, kategoria II-b;

3. Drejtor i Drejtorisë së Azilit dhe të Huajve, si dhe Shtetësisë, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe të Përputhshmërisë, në Ministrinë e Brendshme, kategoria II-b;

4. Drejtor i Drejtorisë së Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe të Parandalimit, në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, kategoria II-b;

5. Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kategoria II-b;

6. Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Mbrojtjen Sociale, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kategoria II-b;

7. Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kategoria II-b;

8. Drejtor i Drejtorisë Operacionale për Çështjet Antikorrupsion, në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, në Ministrinë e Drejtësisë, kategoria II-b;

9. Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, kategoria II-b;

10. Koordinator, në Njësinë Ligjore të Koordinimit të Nismave Prioritare dhe *Acquis*, në Departamentin Rregullator dhe të Përputhshmërisë, në Kryeministri, kategoria II-b;

11. Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Asistencës Financiare të Bashkimit Evropian, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, kategoria II-b;

12. Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Hartimit të Programeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, kategoria II-b.

II. Niveli i ulët drejtues dhe i barasvlershëm

1. Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Kulturës, kategoria III-a;

2. Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit, Arsimimit dhe Kualifikimit të Personelit, në Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Mbrojtjes, kategoria III-a;

3. Përgjegjës i Sektorit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar, në Drejtorinë e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projekteve, në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, kategoria III-a;

4. Përgjegjës i Sektorit të Statistikave dhe Analizave Ekonomike, në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kategoria III-a;

5. Përgjegjës i Sektorit të Ushqimit me Origjinë Shtazore dhe Ushqimit për Kafshë, në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kategoria III-a;

6. Përgjegjës i Sektorit të Huamarrjes në Tregun e Brendshëm, në Drejtorinë e Huamarrjes, në Drejtorinë e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kategoria III-a;

7. Përgjegjës i Sektorit IPARD, në zyrën (Drejtoria) Mbështetëse ZKA, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kategoria III-a;



8. Përgjegjës i Sektorit të Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Fushën Penale, në Drejtorinë për Marrëdhëniet Juridiksionale dhe Bashkëpunimin Ndërgjyqësor, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë, kategoria III-a;

9. Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale, në Drejtorinë e Monitorimit të Profesioneve të Lira, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë, kategoria III-a;

10. Përgjegjës i Sektorit të Politikave dhe Strategiave në Fushën e Energjisë dhe Industrisë, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategiave të Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, kategoria III-a;

11. Përgjegjës i Sektorit të Programeve të Zhvillimit në Fushën e Industrisë, në Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Minerave dhe Industrisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, kategoria III-a;

12. Koordinator në Njësinë e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA, në Departamentin Rregullator dhe të Përputhshmërisë, në Kryeministri, kategoria III-a;

13. Përgjegjës i Sektorit të Bashkëpunimit Dypalësh në Drejtorinë e Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, kategoria III-a;

14. Analist në Sektorin e Kërkimeve, në Drejtorinë e Programimit Strategjik, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, kategoria III-a;

15. Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit të Specializuar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, kategoria III-a/1;

16. Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit të Specializuar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, kategoria III-a/1;

17. Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit të Specializuar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, kategoria III-a/1.

VENDIM

Nr. 769, datë 15.12.2021

PËR KRITERET E MBËSHTETJES SË NISMAVE, TË PROJEKTEVE QË SYNOJNË MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË PAKICAVE KOMBËTARE, RUAJTJEN DHE PROMOVIMIN E IDENTITETIT TË TYRE TË DALLUESHËM KULTUROR, ETNIK, GJUHËSOR, TRADICIONAL E FETAR DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES PËR FINANCIMIN DHE ADMINISTRIMIN E FONDIT PËR PAKICAT KOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 21, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me qëllim sigurimin e mbrojtjes e të promovimit të të drejtave të pakicave kombëtare përdoret fondi i krijuar për pakicat kombëtare, për mbështetjen e nismave dhe të projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional e fetar.

2. Fondi për pakicat kombëtare parashikohet si zë më vete në buxhetin vjetor të shtetit. Kërkesa për këtë fond bëhet pasi Komiteti për Pakicat Kombëtare të jetë konsultuar me përfaqësuesit e pakicave kombëtare dhe, pas konsultimit, përgatit një relacion vjetor, të argumentuar.

3. Fondi për pakicat kombëtare, pas miratimit, administrohet nga Komiteti për Pakicat Kombëtare, në përputhje me rregullat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

4. Për efekt zbatimi të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:



a) “autoritet financues”, autoriteti përgjegjës për sigurimin e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe të interesave të pakicave kombëtare, “Komiteti për Pakicat Kombëtare”;

b) “kandidat”, çdo subjekt përfitues, i cili merr pjesë në një procedurë konkurrimi, sipas këtij vendimi dhe legjislacionit në fuqi;

c) “grant”, shuma e përcaktuar e fondit për mbështetjen e nismave dhe të projekteve, e shpallur në dokumentet e konkurrimit gjatë një procedure konkrete, që i dhurohet pa interes subjektivit përfitues nga autoriteti financues, në përputhje me kriteret e vendosura sipas këtij vendimi dhe legjislacionit në fuqi;

ç) “dokumentet e konkurrimit”, dokumentet që autoriteti financues vë në dispozicion të të gjithë kandidatëve të interesuar për përgatitjen e projektpropozimeve.

5. Subjekte përfituese të granteve, sipas këtij vendimi, janë:

a) organizatat e shoqërisë civile, të cilat janë të regjistruara sipas ligjit, ushtrojnë veprimtari sipas objektit të përcaktuar në statutin e tyre dhe disponojnë NIPT;

b) personat fizikë për mbështetje në kërkime, studime dhe lloje të tjera mbështetjeje individuale, që kontribuojnë në ruajtjen dhe promovimin e identitetit kulturor, etnik, gjuhësor dhe tradicional të pakicave kombëtare.

6. Në procesin e shqyrtimit, të përzgjedhjes së kandidatëve përfitues dhe të shpërndarjes së fondeve për mbështetjen e nismave dhe të projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional dhe fetar, autoriteti financues mbështetet në këto parime:

a) lirinë e pjesëmarrjes e të konkurrimit;

b) mosdiskriminimin e trajtimit e barabartë;

c) transparencën e procedurave dhe të vendimmarrjes, duke u ofruar të gjithë kandidatëve të dhënat e procedurës përkatëse;

ç) përputhshmërinë me objektivat e grantit e me efektivitetin e përdorimit të burimeve, në bazë të sistemit të konkurrimit dhe të kriterëve, që mundësojnë vlerësimin e projektpropozimit dhe të specifikimeve teknike e financiare për përzgjedhjen e shpërndarjen e grantit;

d) mungesën e prapaveprimit, duke përjashtuar mundësinë e shpërndarjes së fondeve për

veprimtari tashmë të realizuara në datën e vendimmarrjes;

dh) paanshmërinë e shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe parandalimin e konfliktit të interesave;

e) përjashtimin e mbivendosjes, që nënkupton shmangien e financimit të së njëjtës veprimtari për të njëjtën interes konkret, më shumë se një herë, gjatë një viti fiskal.

KREU II

PROCEDURA DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES PËR MBËSHTETJEN E NISMAVE DHE TË PROJEKTEVE

1. Procedura e përzgjedhjes së projektpropozimit përfshin fazat e mëposhtme:

a) njoftimin paraprak, publikimin e çdo procedure konkurrimi për një grant të caktuar dhe vënien në dispozicion të dokumenteve përkatëse të konkurrimit;

b) ndryshimet dhe sqarimet e bëra gjatë procedurës, si shtyrje afatesh;

c) dorëzimin e projektpropozimit e regjistrimin e kandidatëve pjesëmarrës nga autoriteti financues;

ç) shqyrtimin e pranueshmërisë së plotësisht të kriterëve të regjistrimit dhe vlerësimin e projektpropozimit;

d) njoftimin e rezultateve të konkurrimit, përfshirë kushtet për përshtatje ose ndryshime;

dh) në rast refuzimi të kandidatëve, deklaratën dhe arsyet e këtij refuzimi;

e) negocimin e mundshëm për ndryshimet e përcaktuara, si kusht për miratimin e projektpropozimit fitues;

ë) negocimin dhe nënshkrimin e kontratës;

f) botimin e informacionit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Brenda muajit janar të çdo viti, Komiteti për Pakicat Kombëtare përgatit një program vjetor “Për pjesëmarrje në procedurë konkurrimi për financim me grante”, që planifikon të organizojë gjatë vitit.

Të gjitha njoftimet për procedurat e konkurrimit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, shpallen në faqen zyrtare të internetit të autoritetit financues.

Komiteti për Pakicat Kombëtare shpall në faqen e tij zyrtare udhëzimet për thirrje për propozime, formularin e aplikimit, formularin e



buxhetit, kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve fitues, një listë të plotë të dokumenteve të nevojshme për t'u paraqitur dhe një kontratë tip.

3. Autoriteti financues përgatit dokumentet e konkurrit, në të cilat përfshihen të paktën:

a) të dhëna të përgjithshme për këtë autoritet;
b) kriteret minimale të kualifikimit dhe dokumentacioni i nevojshëm për të provuar këto kritere;

c) kushtet e grantit;

ç) udhëzimet për afatet dhe formalitetet që duhet të respektohen;

d) të dhënat për kriteret e përdorura për përzgjedhjen e kandidatëve.

4. Kushtet e përgjithshme të pranimit të kandidatëve janë, si më poshtë vijon:

a) të mos jenë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale, si dhe të mos jenë në procedim penal për kryerjen e një veprë penale;

b) në rastin e një personi juridik apo organizate jofitimprurëse, të mos jenë në proces gjyqësor, si dhe të mos jenë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale;

c) të kenë në objektin e ushtrimit të aktivitetit (për personat fizikë) apo në statutin e tyre (për personat juridikë dhe organizatat jofitimprurëse) mbrojtjen, promovimin, mbështetjen e të drejtave të pakicave kombëtare;

ç) të mos jenë subjekt i detyrimeve tatimore në organet shtetërore përgjegjëse;

d) të jenë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në gjykatë dhe të kenë status aktiv;

dh) të kenë aftësi menaxhuese dhe të paraqesin bilancin vjetor të tyre, si një kriter për të shpërndarë në mënyrë jo vetëm cilësore, por edhe të drejtë grantin për financim.

Kandidatët e huaj, për të marrë pjesë në konkurrim, i nënshtrohen legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

5. Kushtet e grantit përmbajnë:

a) karakteristikat e projektit;

b) fushën e veprimt;

c) objektivat e përgjithshëm;

ç) objektivat specifike;

d) fazën e raportimit, financiar e narrativ;

dh) dokumentet mbështetëse, listëprezencën, fotot;

e) dokumentet financiare dhe narrative;

ë) veprimtaritë e nevojshme që duhen kryer;

f) kriteret e vlerësimit të rezultateve.

Granti nuk do të përdoret në asnjë rast për financimin e kostove operative të tjera të kandidatit përfitues, jashtë projektit të përzgjedhur.

6. Autoriteti financues duhet të përcaktojë dhe të përfshijë në njoftimin për pjesëmarrje në një procedurë konkurrimi afatin e dorëzimit të projektpropozimeve. Ky afat nuk mund të jetë më i vogël se 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike nga data e publikimit të njoftimit.

7. Afati për vlerësimin e projektpropozimeve dhe shpalljen e rezultateve është jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga afati i përcaktuar në dokumentet e konkurrit, për dorëzimin e projektpropozimeve. Kandidatët njoftohen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të vlerësimit të rezultateve të konkurrit. Autoriteti financues dhe subjekti përfitues negocionë dhe nënshkruajnë kontratën brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit të rezultateve të konkurrit.

8. Kryetari i Komitetit për Pakicat Kombëtare:

a) siguron hartimin dhe zhvillimin e kushteve të granteve, në përputhje me specifikat e fushave;

b) shpall publikisht grantin dhe kriteret e konkurrit e të përzgjedhjes së kandidatëve përfitues;

c) krijon komisionin e vlerësimit të projektpropozimeve prej jo më pak se 5 (pesë) vetash për çdo procedurë konkurrimi, në përbërje të të cilit marrin pjesë, me cilësinë e të ftuarit dhe me të drejtën për të shprehur qëndrimet e tyre, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile;

ç) përcakton afatet dhe personat përgjegjës për negocimin e kushteve ose të ndryshimeve të nevojshme në projektpropozim, sipas kushteve të përcaktuara nga komisioni i vlerësimit;

d) njofton kandidatët pjesëmarrës në një procedurë të caktuar;

dh) lidh kontratën me fituesin.

9. Komisioni i vlerësimit ka këto detyra:

a) hap, shqyrton dhe vlerëson kriteret e kualifikimit të projektpropozimeve të marra, në përputhje me kriteret dhe afatet e përcaktuara në dokumentet e konkurrit;

b) shpall rezultatet e konkurrit dhe vë në dijeni kandidatët pjesëmarrës për projektet jofituese, duke dhënë dhe arsyet përkatëse.

10. Vlerësimi mbështetet në përputhjen e projektpropozimit të paraqitur nga kandidati



aplikues në procedurat e konkurrimit për financime me grante, me qëllimin e organizatës/kandidatit dhe programin që zbaton, në kapacitetet e kandidatit, në efektshmërinë e aktiviteteve, në pritshmërinë dhe koston e tyre.

Projektet përmbajnë të dhëna për qëllimin, objektivat specifike, veprimtaritë, buxhetin, rezultatet e synuara. Vlerësimi i tyre parashtrohet sipas treguesve të qartë e përcaktimeve të argumentuara.

11. Në kontratë përcaktohen, të paktën, mënyra e transferimit të fondit, dokumentacioni dhe mënyra e raportimit financiar dhe e performancës, llojet e shpenzimeve të njohura e të pranueshme, format e kontrollit, përfshirë detyrimin e subjektit përfitues për të vënë në dispozicion të Kontrollit të Lartë të Shtetit dokumentacionin për veprimtarinë financiare të kryer, mënyra e dokumentimit të shpenzimeve dhe e produktit/rezultateve të projektpropozimit të financuar, si dhe kushtet apo përgjegjësitë e tjera të ndërsjella.

12. Autoriteti financues shpall në faqen e tij zyrtare të internetit emrat e të gjithë përfituesve të projekteve, përmbledhjen e projekteve të financuara dhe shumat përkatëse të granteve.

13. Çdo projekt i financuar monitorohet nga autoriteti financues për zbatimin e veprimtarive të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi.

KREU III DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohet Komiteti për Pakicat Kombëtare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIMI

Nr. 770, datë 15.12.2021

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË SHKOLLËS 9- VJEÇARE “DEMOKRACIA”, VALIAS I RI, BASHKIA KAMZË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAMZË SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare “Demokracia”, Valias i Ri, Bashkia Kamzë, në masën 387 798 722 (treqind e tetëdhjetë e shtatë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e dy) lekë pa TVSH.

2. Bashkisë Kamzë, në buxhetin e vitit 2021, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 77 559 744 (shtatëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare “Demokracia”, Valias i Ri, Bashkia Kamzë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021.

3. Bashkia Kamzë caktohet si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare “Demokracia”, Valias i Ri, Bashkia Kamzë, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

**VENDIM****Nr. 771, datë 15.12.2021**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 587, DATË 22.7.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), TË DËMTUARA, NË ZONAT E REJA PËR ZHVILLIM DHE RINDËRTIM NË TË NJËJTIN TRUALL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”; 16, pika 3 dhe 36, shkronja “a”, pika 1, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) në pikën 2.1, shifra “... 4 666 179 207 (katër miliardë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatë) lekë pa TVSH ...” zëvendësohet me “... 6 526 179 207 (gjashtë miliardë e pesëqind e njëzet e gjashtë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatë) lekë pa TVSH ...”;

b) pika 3.1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3.1 Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 6 526 179 207 (gjashtë miliardë e pesëqind e njëzet e gjashtë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatë) lekë pa TVSH, për rindërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e reja për zhvillim dhe

rindërtim në të njëjtin truall, në bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Krujë, Kurbin, Mirditë, Lezhë, Shijak dhe Vorë. Efektet financiare, sipas kësaj pike, do të përballohen:

a) 2 626 734 455 (dy miliardë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë milionë e shtatëqind e tridhjetë e katër mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë) lekë nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë;

b) 3 899 444 752 (tre miliardë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e katërqind e dyzet e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) lekë nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021.”.

2. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Arben Ahmetaj****VENDIM****Nr. 772, datë 15.12.2021**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 202, DATË 5.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE, NDËRTIMIN DHE RIKONSTRUKSIONIN E INFRASTRUKTURËS PUBLIKE, SI DHE ÇDO NDËRRHYJE TJETËR NË FUNKSION TË RINDËRTIMIT TË KËTYRE BANESAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.



137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 2.2, të vendimit nr. 202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Shifra “... 1 375 821 704 (një miliard e treqind e shtatëdhjetë e pesë milionë e tetëqind e njëzet e një mijë e shtatëqind e katër) lekë pa TVSH ...” zëvendësohet me “... 1 538 821 704 (një miliard e pesëqind e tridhjetë e tetë milionë e tetëqind e njëzet e një mijë e shtatëqind e katër) lekë pa TVSH ...”.

b) Në shkronjën “a”, shifra “... 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë pa TVSH ...” zëvendësohet me “... 663 000 000 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre milionë) lekë pa TVSH ...”.

2. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM Nr. 773, datë 15.12.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 645, DATË 3.8.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT) DHE NDËRTESAVE PUBLIKE, NË ZONAT E REJA PËR ZHVILLIM, NË NJËSITË ADMINISTRATIVE 4 E 8, ZONA ‘5 MAJ’ DHE NJËSINË ADMINISTRATIVE 6, ZONA ‘KOMBINAT’, BASHKIA TIRANË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16, pika 3,

dhe 36, pika 1, shkronja “a”, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 2.1, të vendimin nr. 645, datë 3.8.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shifra “... 990 233 627 (nëntëqind e nëntëdhjetë milionë e dyqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë) lekë” zëvendësohet me shifrën “... 1 490 233 627 (një miliard e katërqind e nëntëdhjetë milionë e dyqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH ...”.

2. Efektet financiare përballohen nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2021.

3. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM Nr. 774, datë 15.12.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 212, DATË 11.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të



fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2.1, e vendimit nr. 212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2.1 Përdorimi i fondit, i miratuar në buxhetin e vitit 2021, të jetë në masën 4 886 106 464 (katër miliardë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e gjashtë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Tiranë i transferohet, në formën e transfertës së pakushtëzuar, fondi në masën prej 4 839 106 464 (katër miliardë e tetëqind e tridhjetë e nëntë milionë e njëqind e gjashtë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekësh pa TVSH;

b) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 47 000 000 (dyzet e shtatë milionë) lekësh pa TVSH.”.

2. Efektet financiare të përballohen nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2021.

3. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM Nr. 775, datë 15.12.2021

PËR MIRATIMIN E LLOJEVE TË SINJALEVE TË ALARMIT, NUMRIT DHE MËNYRËS SË PËRDORIMIT TË TYRE NË RASTET E FATKEQËSIVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 50, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e llojeve të sinjaleve të alarmit, numrit dhe mënyrës së përdorimit të tyre në rastet e fatkeqësive, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Sinjalet e alarmit për njoftimin e hershëm të popullsisë, për marrjen e masave të menjëhershme, për mbrojtjen nga fatkeqësitë, të jenë të kuptueshme nga të gjitha kategoritë e popullsisë. Gjuha e përdorur të jetë e thjeshtë dhe të përdoren mesazhe me figura.

3. Sinjalet e alarmit ndahen në:

a) sinjale pamore, si më poshtë vijon:

i. tabela vertikale elektronike për dhënien e mesazheve të ndryshueshme alfanumerike me instalime të paracaktuara ose të lëvizshme;

ii. tabela vertikale statike me figura dhe mesazhe paralajmëruese me instalime të paracaktuara ose të lëvizshme;

iii. sinjale tymuese ose fluturuese;

b) sinjale zanore që jepen përmes:

i. sirenave statike ose të lëvizshme;

ii. sistemeve zanore të lëvizshme.

4. Sinjalet e alarmit transmetohen përmes:

a) rrjeteve të komunikimeve elektronike të lëvizshme;

b) rrjeteve të shpërndarjes së përmbajtjeve audio dhe audiovizive, si:

i. rrjetet e operatorëve kombëtarë audio;

ii. rrjetet e operatorëve kombëtarë audiovizivë.

5. Në varësi të shtrirjes territoriale, sinjalet pamore të jenë jo më pak se një shenjë paralajmëruese për 1 000 banorë. Autoriteti përgjegjës për caktimin e vendeve, ku vendosen sinjalet e alarmit për ruajtjen dhe mbajtjen në gatishmëri, është prefekti i qarkut në bashkëpunim me kryetarin e bashkisë.



6. Kohëzgjatja e përdorimit të sinjaleve të alarmit përkon me kohëzgjatjen e fatkeqësisë.

7. Institucionet publike dhe subjektet private, përgjegjëse për administrimin e sinjaleve të alarmit, vetëm ose në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, sigurojnë trajnimin e personelit të tyre për mënyrën e përdorimit të sistemeve të alarmit.

8. Përdorimi i sinjaleve bëhet i kombinuar për informimin e të gjitha kategorive të popullsisë.

9. Efektet financiare të këtij vendimi të mbulohen nga buxheti i shtetit akorduar bashkive, brenda fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile.

10. Ngarkohen ministri përgjegjës për mbrojtjen civile, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, ministritë e linjës, prefekti i qarkut dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 776, datë 15.12.2021

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE
PROCEDURAVE TË KRIJIMIT TË
SISTEMIT TË GJURIMIT TË
ARTIKUJVE PIROTEKNIKË²**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”, me propozim të ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Etiketimin e artikujve piroteknikë me një numër regjistrimi, që përmban të dhënat e mëposhtme:

² Ky vendim është përafëruar pjesërisht me direktivën 2014/58 BE, të Komisionit Evropian, datë 16 prill 2014, “Për ngritjen e një sistemi për gjurmimin e artikujve piroteknikë, në zbatim të direktivës 2007/23/KE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit”; numri CELEX 32014L0058, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 115, datë 16.8.2014, f. 28–31.

a) numrin katërshifror të identifikimit të Organizmit Evropian të Notifikuar që ka lëshuar certifikatën e përputhshmërisë, në përputhje me nenin 19, të ligjit nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”, sipas procedurës së vlerësimit të përputhshmërisë, referuar:

i. kontrollit të tipit EU (moduli B);

ii. përputhshmërisë së bazuar të verifikimit të njësisë së produktit (moduli G);

iii. përputhshmërisë së bazuar të sigurisë së plotë të cilësisë (moduli H);

b) me shkronja kapitale, në format të shkurtuar, kategorinë e artikullit piroteknik për të cilin përputhshmëria është certifikuar, si më poshtë:

i. F1, F2, F3 ose F4, për fishekzjarrët e kategorive 1, 2, 3 dhe 4;

ii. T1 ose T2, për artikujt piroteknikë teatralë të kategorive T1 dhe T2;

iii. P1 ose P2, për artikujt e tjerë piroteknikë të kategorive P1 dhe P2;

c) numrin e ekzaminimit të përdorur nga Organizmi Evropian i Notifikuar për artikullin piroteknik.

2. Numri i regjistrimit strukturohet “XXXX — YY — ZZZZ ...”, ku XXXX i referohet shkronjës “a”, të pikës 1; YY i referohet shkronjës “b”, të pikës 1, dhe ZZZZ... i referohet shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij vendimi.

3. Prodhuesit dhe importuesit e artikujve piroteknikë kanë detyrimin që:

a) të mbajnë një regjistër fizik dhe elektronik të të gjithë numrave të regjistrimit të artikujve piroteknikë të prodhuar ose të importuar prej tyre, së bashku me emrin e tyre tregtar, llojin e përgjithshëm dhe/apo nëntipin, dhe vendin e prodhimit për 10 vjet, pas vendosjes në treg të artikullit, sipas formatit të përcaktuar në shtojcën I, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) të transferojnë të dhënat tek autoritetet kompetente licencuese për veprimtarinë e tyre, në rast se prodhuesi ose importuesi pushon veprimtarinë e tij;

c) të regjistrojnë vendndodhjen e çdo artikulli piroteknik, ndërkohë që artikulli piroteknik është në zotërimin ose kujdestarinë e tyre, derisa ai të transferohet drejt një operatori tjetër ekonomik ose të përdoret;

ç) të testojnë, në intervale të rregullta, sistemin për mbledhjen e të dhënave, me qëllim që të



sigurohen që ai të mbetet i vlefshëm dhe të sigurohen për cilësinë e të dhënave të regjistruara;

d) administratori i subjektit ose drejtuesi teknik të japin informacion në lidhje me sistemin në çdo kohë që kërkohet nga autoritetet kompetente edhe jashtë orarit normal të punës;

dh) të vendosin në dispozicion të autoriteteve kompetente dhe të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut të gjithë informacionin e përmendur në shkronjën “a”, të kësaj pike, sipas kërkesës së bërë nga këto autoritete.

4. Artikujt piroteknikë, të cilët janë vendosur në treg para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të lejohet të tregtohen.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Arben Ahmetaj

Shtojca I

Formati i regjistrimit i referuar në pikën 3, shkronja “a”

Numri i regjistrimit	Data e lëshimit të certifikatës së shqyrtimit të tipit EC (moduli B), certifikata e konformitetit (moduli G) ose miratimi i sistemit të cilësisë së sigurisë së produktit (moduli H) dhe data e skadimit, sipas rastit	Prod huesi	Tipi i produktit (i përgjithshëm) dhe nëntipi, nëse zbatohet	Moduli i konformitetit i fazës së prodhimit ¹	Organi i notifikuar që kryen vlerësimin e konformitetit në fazën e prodhimit ¹	Informa cion shtesë

¹ Duhet të plotësohet gjithmonë nëse kryhet procedura e vlerësimit të përputhshmërisë sipas modulit B, të referuar në nenin 19, të ligjit nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”. Nuk kërkohet për procedurat e vlerësimit të përputhshmërisë, të referuara në nenin 19, të ligjit nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”, (modulet G dhe H). Informacioni duhet të jepet (kur dihet), nëse përfshihet një organizëm evropian tjetër i notifikuar.

VENDIM

Nr. 779, datë 15.12.2021

PËR SHPËRBLIMIN E PENSIONISTËVE PËR FESTAT E FUNDVITIT 2021

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin në masën 5 000 (pesë mijë) lekë të personave përfutues, sipas kategorive të mëposhtme:

a) Personat, që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti, pension familjar dhe pension social, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për

sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”.

b) Personat, që marrin pension, sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”.

c) Personat, që marrin pension sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, personat që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, dhe personat, që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar.

ç) Personat, që marrin pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të



punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

d) Personat, që nuk përfitojnë pension, por që trajtohen vetëm me shpërblimin financiar si veteranë të LANÇ-it, sipas vendimit nr. 190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar”, si dhe personat, të cilët marrin vetëm pension të posaçëm për merita të veçanta, sipas dispozitave të ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”.

dh) Personat, që nuk përfitojnë pension, por që përfitojnë vetëm pension shtetëror të posaçëm, të caktuar në përputhje me nenin 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

e) Personat, që nuk përfitojnë pension, por janë përfitues vetëm të trajtimit të veçantë financiar, sipas neneve 5/1/a ose 5/1/b, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

ë) Personat, që nuk përfitojnë pension nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, por përfitojnë pension suplementar të caktuar, sipas ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar.

f) Personat, që marrin pension për shkak të profesionit të vështirë, sipas nenit 5, të ligjit nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”.

2. Të drejtën për të përfituar shpërblimin, në masën e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, e kanë edhe ata persona, që kanë datë të fillimit të pensionit deri në datën 31.12.2021, duke përfshirë edhe këtë datë.

3. Shpërblimet kalohen në llogaritë e pensionistëve në muajin dhjetor 2021 dhe paguhen gjatë këtij muaji. Në rastet kur pagesat efektive nuk kryhen brenda muajit dhjetor 2021, ato paguhen

gjatë vitit të ardhshëm. Shpërblimet e patërhequra parashkruhen me kalimin e 36 muajve nga data e miratimit të këtij vendimi.

4. Administrimi i fondeve buxhetore të shpërblimit të pensionistëve, caktimi i shpërblimit për çdo përfitues dhe pagesa realizohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Posta Shqiptare sh.a., dhe bankat e nivelit të dytë, sipas të njëjtave procedura që zbatohen për administrimin e fondit të sigurimeve shoqërore.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, që llogariten në shumën 3 440 000 000 (tre miliardë e katërqind e dyzet milionë) lekë për shpërblimin dhe 60 000 000 (gjashtëdhjetë milionë) lekë shpenzime administrative, përballohen nga buxheti i sigurimeve shoqërore, i miratuar për vitin 2021.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 782, datë 15.12.2021

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2022, TË
ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT
TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË
UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2022, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, në shumën 53 154 530 (pesëdhjetë e tre



milione e njëqind e pesëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë, sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Arben Ahmetaj

ENTI RREGULLATOR I UJIT (ERRU)

ANEKSI NR. 1

PLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2022

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2022 (lek)
1	Pagat dhe shtesat e tjera	31,660,650
2	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	5,511,830
3	Shërbime e furniturë	13,625,050
4	Investime	2,357,000
	TOTALI	53,154,530

VENDIM

Nr. 783, datë 15.12.2021

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR, NYJA TEG”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i segmentit rrugor, nyja TEG”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “tokë arë” “truall” dhe “ndërtësë”, me vlerë të përgjithshme prej 64 499 504 (gjashtëdhjetë e katër milionë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 64 499 504 (gjashtëdhjetë e katër milionë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e katër) lekësh, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.



8. Autoriteti Rrugor Shqiptar kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe bën kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, pezullon të gjitha

transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj



LISTA E PRONARËVE, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR, NYJA TEG”

Nr.	PRONARI	ZK	Nr. i pas.	Lloji i pasurisë	Sip. totale	VLERËSIMET												VLERA TOTALE (LEKË)	Shënime
	Emri i pronarit					Sip. shprons. (m²)	TOKE ARË			TOKE TRUALL			OBJEKT SOC.-EK.		OBJEKT BANIMI				
							Sip. e shpron.	Vlera	Total	Sip e shpron.	Vlera	Total	Sip e shpron.	Total	Sip e shpron.	Vlera	Total		
1	Kadri Hasan Husha	2704	533/4	Arë + truall	825	825	325	523	169,975	500	3,283	1,641,500	315	15,759,302	73	66,500	4,867,800	22,438,577	Konfirmim ASHK
2	Albsina Group	2529	574/3	Arë	2,400	206	206	523	107,738									107,738	Konfirmim ASHK
3	Avni Doda	2529	583/13	Arë	5,372	1,050	1,050	523	549,150									549,150	Konfirmim ASHK
4	Pajtim Struga	2529	583/14	Arë + truall	4,000	365	365	523	190,895									190,895	Konfirmim ASHK
5	Pullumb Tahir Krraba Ismet	2529	583/28	Truall + ndërtesë	4,116	486				486	3,283	1,595,538	1,100	38052267				39,647,805	Konfirmim ASHK
6	Renalda Refit Korbeci	2529	583/17	Pemëtore	4,000	2,680	2,680	523	1,401,640									1,401,640	Konfirmim ASHK
7	Jonald Ali Agolli	2704	547/76	Ullishte	1,875	129	129	523	67,467									67,467	Konfirmim ASHK
8	Luan Pelivan Betaj	2704	547/66	Ullishte	2,795	57	57	523	29,811									29,811	Konfirmim ASHK
9	Jonald Ali Agolli	2704	547/77	Ullishte	2,250	127	127	523	66,421									66,421	Konfirmim ASHK
VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT																		64,499,504	

**VENDIM****Nr. 784, datë 15.12.2021**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 843, DATË 28.10.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR ‘RRUGA
LIDHËSE E APOLONISË’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 843, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 3, shifra “... 3 620 740 (tre milionë e gjashtëqind e njëzet mijë e shtatëqind e dyzet) lekë ...” zëvendësohet me “... 4 089 068 (katër milionë e

tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëdhjetë e tetë) lekë ...”.

b) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 4 089 068 (katër milionë e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga fondet e miratuara për Autoritetin Rrugor Shqiptar.”.

c) Të dhënat për pasurinë me numër rendor 15, në tabelën bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me të dhënat e tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj**



LISTA EMËRORE E PRONARIT PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 843, DATË 28.10.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘RRUGA LIDHËSE E APOLONISË’”

Në VKM-në nr. 843, datë 28.10.2020										Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 843, datë 28.10.2020									
Nr. rendor sipas VKM-së	Emër Atësi Mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip.	Sip. e shpronësuar/ m²	Çmimi në lek/m²	Vlera totale për shpronësim	Shënime	Nr. rendor sipas VKM-së	Emër Atësi Mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip.	Sip. e shpronësuar/ m²	Çmimi në lek/m²	Vlera totale për shpronësim	Shënime
					Totalë										Totalë				
					/m²										/m²				
15	Vasil Lili Cuni	3015	100/1	Are	4,929	216	269	58,105	Konfirmuar nga ASHK-ja	15	Vasil Lili Cuni	3015	100/24	Are	5088	1957	269	526,433	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Vlera totale				4,929.0	1,957		58,105			Vlera totale				5,088.0	1,957		526,433	
Vlera shtesë në lekë që kërkohet për shpronësim 468,328 lekë																			
Shënime. 1. Për tokën “arë”, çmimi i llogaritur është marrë nga vendimi nr. 89, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.																			



VENDIM

Nr. 785, datë 15.12.2021

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 736, DATË 20.10.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘SISTEMIMI I BLOKUT TË BANIMIT NË LAGJEN ‘KONGRESI I LUSHNJËS’, PALLATI 31, TEK ISH-KINEMAJA’, LUSHNJË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 26, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 736, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi projektit ‘Sistemimi i bllokut të banimit në lagjen ‘Kongresi i Lushnjës’, pallati 31, tek ish-Kinemaja’, Lushnjë”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Lushnjë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Lushnjë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Arben Ahmetaj

VENDIM

Nr. 789, datë 15.12.2021

PËR KRITERET, MËNYRËN E SHPËRBLIMIT DHE TRAJTIMIN E SPORTISTËVE, QË PËRFITOJNË STATUSIN E NIVELIT TË LARTË, DHE TRAJNERËVE TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 27, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve për përfitimin nga sportisti të statusit të nivelit të lartë, sipas rezultateve të arritura në veprimtaritë ndërkombëtare apo kombëtare. Klasifikimi i këtyre rezultateve në veprimtaritë ndërkombëtare dhe kombëtare jepet sipas tabelave I dhe II, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Sportistët mbajnë statusin e nivelit të lartë nga momenti i marrjes së rezultatit zyrtar në veprimtaritë ndërkombëtare apo kombëtare deri në marrjen zyrtare të rezultatit nga një sportist tjetër pasardhës në atë sport.

3. Sportistët, që gëzojnë statusin e nivelit të lartë, përfitojnë shpërblim dhe trajtim, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

4. Masa e shpërblimit financiar, për çdo rezultat të arritur, jepet sipas tabelave I e II, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, e jepet pas shpalljes së rezultateve përfundimtare zyrtare të veprimtarisë sportive nga federata ndërkombëtare/kombëtare e atij sporti.

5. Integrimi i sportistëve në sistemin arsimor me drejtim sportiv, i sigurisë kombëtare e mbrojtjes dhe punësimi i tyre në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme përfitohet vetëm 1 (një) herë brenda periudhës së përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi.

6. Sportistët e sporteve individuale, të kategorisë “të rinj”, që arrijnë rezultate në veprimtaritë ndërkombëtare, sipas tabelës I, shpërblehen në masën 30 (tridhjetë) % të vlerës së përcaktuar për kategorinë “të rritur”.



7. Trajnerët e sportistëve, që kanë përfituar statusin e nivelit të lartë, sipas këtij vendimi, shpërblehen në masën 40 (dyzet) % të vlerës që përfiton sportisti me këtë status.

8. Sportistët e nivelit të lartë dhe trajnerët e tyre, pjesëmarrës në veprimtaritë kombëtare, të përcaktuara në rregulloret e federatave sportive përkatëse dhe në veprimtari ndërkombëtare, për përgatitjen e tyre përfitojnë trajtim ushqimor në natyrë ose në vlerë, si dhe trajtim mjekësor.

9. Trajtimi ushqimor është jo më pak se 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë në ditë, për 25 (njëzet e pesë) ditë në muaj.

10. Shpenzimet për trajtimin mjekësor vlerësohen sipas dokumenteve justifikuese për periudhën e trajtimit.

11. Trajtimi ushqimor e mjekësor për periudhën e grumbullimit dhe të pjesëmarrjes në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare të sportistit, sipas tabelës I, në përbërje të ekipit përfaqësues kombëtar, mbulohet nga federata sportive përkatëse.

12. Efektet financiare për shpërblimin e trajtimin e sportistëve të nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre, në sportet individuale, që arrijnë rezultate në veprimtaritë ndërkombëtare, sipas tabelës I, përballohen nga fondet e buxhetit të shtetit, miratuar për ministrinë përgjegjëse për sportin. Masa e shpërblimit për sportistët e nivelit të lartë dhe trajnerët e tyre jepet me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin.

13. Për shpërblimin financiar dhe trajtimin e sportistit të nivelit të lartë, për sportet individuale, që kanë marrë rezultate në veprimtaritë ndërkombëtare, sipas tabelës I, federata sportive përkatëse paraqet kërkesën pranë ministrisë përgjegjëse për sportin. Të drejtën për të paraqitur kërkesë e ka edhe sportisti apo trajneri i tij. Kërkesa shoqërohet me rezultatin përfundimtar të analizave *doping*, referuar veprimtarisë ndërkombëtare, në të cilën sportisti ka marrë rezultatin. Ministria përgjegjëse për sportin verifikon përmbushjen e kriterëve pas marrjes së kërkesës. Fondet alokohen për llogari të sportistit dhe të trajnerit të tij.

14. Gjatë vitit kalendarik, përjashtuar periudhën e grumbullimit dhe të pjesëmarrjes në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare të sportistit, sipas tabelës I, sportisti dhe trajneri i tij përfitojnë trajtim ushqimor

e mjekësor për përgatitjen sportive dhe pjesëmarrjen në veprimtaritë kombëtare zyrtare.

15. Efektet financiare për shpërblimin e trajtimin e sportistëve të nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre, që arrijnë rezultate në veprimtaritë kombëtare, sipas tabelës II, përballohen nga fondet e njësisë të vetëqeverisjes vendore ose të ardhura të tjera të ligjshme. Masa e shpërblimit për sportistët e nivelit të lartë dhe trajnerët e tyre jepet me urdhër të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

16. Për shpërblimin financiar dhe trajtimin e sportistit të nivelit të lartë, për sportet individuale, apo të ekipit sportiv, për sportet kolektive, që kanë marrë vendin e parë në kampionatin kombëtar, organizata sportive përkatëse, që ushtron veprimtarinë në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, paraqet kërkesën pranë saj. Të drejtën për të paraqitur kërkesë e ka edhe sportisti apo trajneri i tij. Kërkesa shoqërohet me rezultatin përfundimtar të federatës shqiptare të atij sporti, referuar kampionatit kombëtar, në të cilin sportisti apo ekipi sportiv ka marrë vendin e parë. Njësia e vetëqeverisjes vendore verifikon përmbushjen e kriterëve pas marrjes së kërkesës. Fondet alokohen për organizatën sportive të sportistit/ekipit sportiv dhe trajnerit të tij, për llogari të këtyre të fundit.

17. Sportistët, të cilët kanë përfituar statusin e nivelit të lartë, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 105/2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 79/2017, 'Për sportin'", trajtohen sipas parashikimeve të këtij vendimi.

18. Vendimi nr. 687, datë 14.11.2018, i Këshillit të Ministrave, "Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë", shfuqizohet.

19. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, njësiti e vetëqeverisjes vendore dhe organizatat sportive shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj



Tabela I

VEPRIMTARITË NDËRKOMBËTARE ZYRTARE

Veprimtaria	Rezultati	Masa e shpërblimit
	Rekord olimpik	15 000 000 lekë
	Rekord botëror	15 000 000 lekë
	Rekord evropian	6 000 000 lekë
	Rekord mesdhetar	3 000 000 lekë
	Rekord ballkanik	1 500 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i parë	10 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i dytë	7 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i tretë	5 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i katërt	3 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i pestë	2 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i gjashtë	1 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i shtatë	800 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i tetë	500 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i parë	10 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i dytë	6 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i tretë	4 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i katërt	2 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i pestë	1 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i gjashtë	800 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i shtatë	600 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i tetë	400 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i parë	4 000 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i dytë	2 000 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i tretë	1 000 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i katërt	800 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i pestë	600 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i gjashtë	400 000 lekë
Lojëra Mesdhetare	Vendi i parë	2 000 000 lekë
Lojëra Mesdhetare	Vendi i dytë	1 000 000 lekë
Lojëra Mesdhetare	Vendi i tretë	800 000 lekë
Kampionati Ballkanik	Vendi i parë	1 000 000 lekë

Shënim. Në sportin e peshëngritjes, sportistët që arrijnë rezultate në veprimtaritë ndërkombëtare, në dygarësh (total), sipas tabelës I, shpërblehen në masën 30% të vlerës së përcaktuar për atë rezultat.

Tabela II

VEPRIMTARITË KOMBËTARE ZYRTARE

	Rekord kombëtar	200 000 lekë
Kampionati kombëtar në sportet individuale	Vendi i parë	100 000 lekë
Kampionati kombëtar i kategorisë më të lartë në sportet kolektive	Vendi i parë	500 000 lekë

**VENDIM****Nr. 790, datë 15.12.2021****PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË DREJTORIT TË CIRKUT KOMBËTAR**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Ilirjan Gjini, drejtor i Cirkut Kombëtar, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

URDHËR**Nr. 378, datë 10.12.2021****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; dhe të nenit 11, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Brendshme, zëvendësministrit të Brendshëm, znj. Romina Kuko, nga data 10.12.2021 deri më datë 13.12.2021.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Brendshëm, znj. Romina Kuko.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

URDHËR**Nr. 520, datë 3.12.2021****PËR NDALIMIN E HYRJES NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË TË SHTETASVE TË HUAJ ME HISTORI UDHËTIMI NË VENDET E AFRIKËS SË JUGUT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 3, germa “a”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar; si dhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 4881, datë 2.12.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e hyrjes në Republikën e Shqipërisë të shtetasve të huaj me histori udhëtimi brenda 14 ditëve të fundit në vendet: Afrikë e Jugut, Kenia, Angola, Zambia, Bostwana, Senegal, Lesoto dhe Eswati, duke filluar nga data 3.12.2021 deri në datë 23.12.2021.

2. Vetëkarantinimin e detyrueshëm, për një periudhë 14-ditore, për personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, që vijnë në Shqipëri dhe kanë histori udhëtimi 14 ditët e fundit para mbërritjes, në vendet e përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri.

3. Urdhri t'i përcillet ministrisë përgjegjëse për çështjet e jashtme, me qëllim njohjen e tij nga të gjitha përfaqësitë diplomatike në Republikën e Shqipërisë.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe organet kompetente për dhënien e masave administrative, sipas aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë